

RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Mbi pasqyrat financiare te shoqerise :

«A&V - GAS» Sha Durres

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR	2
PASQYRA E BILANCIT	4
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALEVE TE VETA	7
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8
1. Te dhena te pergjithshme mbi Shoqerine	8
2. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel	8
3. Likuiditete dhe Vlera te tjera Arke.	10
4. Kliente per shitje e sherbime.....	10
5. Llogari kerkesa te tjera te arketueshme.....	11
6. Inventari.....	11
7. Aksione ne shoqerite e kontrolluara	11
8. AAM-Toka, ndertesa, makineri e paisje, aktive te tjera afatgjata.....	12
9. Huate dhe obligacionet afatshkurtra	13
10. Te pagueshme ndaj furnitoreve	13
11. Detyrime tatimore	13
12. Parapagimet e arketueshme	13
13. Huamarrje afatgjata	13
14. Huamarrje te tjera afatgjata.....	13
15. Kapitali	14
16. Te Ardhurat.....	14
17. Mallra, lendet e para dhe sherbimet.....	14
18. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	14
19. Shpenzime personeli	15
20. Shpenzime amortizimi.....	15
21. Te ardhura dhe shpenzime financiare.....	15
22. Shpenzimet e tatim mbi fitimin.....	15
23. Transaksionet me palet e lidhura.....	15

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Per Drejtuesit dhe Aksioneret e
A&V-Gas

Raport mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te bashkangjitura ketij raporti te A&V-Gas (ne vijim referuar si "Shoqeria") qe perfshijne pasqyren e bilancit kontabel me 31 Dhjetor 2012 dhe pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve, pasqyren e ndryshimeve te kapitalit dhe pasqyren e flukseve monetare per vitin e mbyllur ne kete date, si dhe nje permbledhje te politikave te rendesishme kontabel dhe shenime te tjera shpjeguese.

Pergjegjesia e Drejtimit per pasqyrat financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen e vertete dhe te sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe ligjin Nr. 9228 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", dhe per kontrollet e brendshme qe drejtimi i konsideron te nevojshme per pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, qofte nga gabimet apo mashtrimet.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Ne kemi kryer auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te perftuar siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidence auditimi ne lidhje me vlerat dhe pohimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e perzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke perfshire vleresimin e rrezikut te anomalive materiale te pasqyrave financiare, si rezultat i gabimit apo mashtrimit. Gjate vleresimit te rrezikut audituesi konsideron kontrollin e brendshem te pershtatshem per pergatitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te Shoqerise me qellim qe te planifikoje procedura auditimi qe jane te pershtatshme me rrethanat, por jo me qellim per te shprehur nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te Shoqerise. Nje auditim gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdorura dhe pershtatshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe vleresimin e pergjithshem te paraqitjes se pasqyrave financiare.

CORRESPONDENT OF MAZARS

GJINI CONSULTING
Rr. PJETER BOGDANI P.39/1, AP.4/4 – TEL/FAX +355 42 222 889

Registered Auditors
Legal Mention


Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te siguruar bazat per opinionin tone te auditimit.

Bazat per Opinionin me Rezerve

1. Sic pershkruhet ne shenimin 4 dhe 10 te pasqyrave financiare gjendja e llogarive te arketueshme dhe llogarive te pagueshme me 31 Dhjetor 2012 paraqitet perkatesisht ne vlerat 726,161 mije leke dhe 1,106,270 mije leke. Deri ne daten e Raportit te Auditimit ne nuk kemi perfunduar nje pjese te rendesishme te procedurave te auditimit ne lidhje me marrjen e kkonfirmimeve direkte nga palet e treta. Pas perfundimit te procedurave alternative ne nuk arrihem te perfitonim nje siguri te arsyeshme ne lidhje me saktesine e shumave te perfshira ne keto zera te pasqyrave financiare.
2. Sic pershkruhet ne shenimin 6 te pasqyrat financiare te shoqerise, gjendja e inventareve te Shoqerise me 31 Dhjetor 2012 eshte 347,019 mije Leke. Ne jemi caktuar si auditues te Shoqerise me 20 Mars 2013, ndaj nuk kemi marre pjese ne inventarizimin fizik ne fund te vitit. Per sa me siper ne nuk arrihem te perfitonim nje siguri te arsyeshme ne lidhje me saktesine e gjendjeve te inventarit.

Opinion me Rezerve

Sipas opinionit tone, me perjashtim te efekteve te ceshtjeve te pershkuara ne paragrafet e Bazes per Opinionin me Rezerve, pasqyrat financiare paraqesin ne te gjitha aspektet materiale, ne menyre te drejte, pozicionin financiar te Shoqerise A&V-Gas me daten 31 Dhjetor 2012, performancen e saj financiare dhe flukset e parase per vitin e mbyllur ne kete date ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.



Gjini Consulting sh.p.k
Rr. "Pjeter Bogdani", Pall 39/1, Ap4/4,
Tirane, Shqiperi

24 Qershor 2013

CORRESPONDENT OF MAZARS

GJINI CONSULTING
Rr. PJETER BOGDANI P.39/1, AP 4/4 – TEL/FAX +355 42 222 889

Registered Auditors
Legal Mention

PASQYRA E BILANCIT

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

AKTIVET	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Aktive Afatshkurtra			
Mjetet Monetare	3	11,194,988	11,281,590
Llogari kerkesa te arketueshme	4	726,161,419	449,389,921
Llogari kerkesa te tjera te arketueshme	5	1,013,588,813	678,024,510
Inventari	6	347,019,272	197,086,693
Total i Aktiveve Afatshkurtra		2,097,964,492	1,335,782,714
Aktive Afatgjata			
Investime financiare afatgjata			
Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	7	2,000,000	2,000,000
Aktive Afatgjata Materiale	8	6,923,142	2,831,455
Totali i Aktiveve Afatgjata		8,923,142	4,831,455
TOTALI AKTIVEVE		2,106,887,634	1,340,614,169
PASIVET DHE KAPITALI			
Pasivet Afatshkurtra			
Huate dhe obligacionet afatshkurtra	9	268,609,077	264,921,405
Te pagueshme ndaj furnitoreve	10	1,106,270,268	584,458,857
Detyrimet tatimore	11	12,033,192	28,998,137
Parapagimet e arketueshme	12	6,115,010	
Passive Totale Afatshkurtra		1,393,027,547	878,378,399
Pasivet Afatgjata			
Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	13	92,336,988	114,574,197
Huamarrje te tjera afatgjata	14	60,774,588	40,430,404
Passive Totale Afatgjata		153,111,576	155,004,601
Totali i pasiveve		1,546,139,123	1,033,383,000
Kapitali			
Kapitali i aksionar		68,948,051	68,948,051
Rezerva te tjera		238,283,118	
Fitimi i pashperndare			(605,002)
Fitimi (humbje) e vitit financiar		253,517,342	238,888,120
Totali i Kapitalit	15	560,748,511	307,231,169
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		2,106,887,634	1,340,614,169

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

Pershkrimi	Shenime	31.12.2012	31.12.2011
Shitje neto	16	5,820,456,123	5,330,833,729
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		24,920,365	13,850,803
Mallra, lendet e para dhe sherbimet	17	(5,306,924,544)	(4,859,549,757)
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfryt	18	(225,713,377)	(200,774,431)
Shpenzimet e personelit	19	(6,234,925)	(5,410,780)
Pagat		(5,403,300)	(4,703,631)
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore		(831,625)	(707,149)
Amortizimi dhe Zhvleresimet	20	(1,093,423)	(593,319)
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		305,410,219	278,356,245
Te ardhura dhe shpenzime financiare			
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		(23,359,533)	(19,655,255)
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		2,575,240	9,170,808
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	21	(20,784,293)	(10,484,447)
Fitimi (humbja) para tatimit		284,625,926	267,871,798
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	22	(31,108,584)	(28,983,678)
Fitim (humbje) neto e vitit financiar		253,517,342	238,888,120

PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012

Pershkrimi	31.12.2012	31.12.2011
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	284,625,926	267,871,797
Rregullime për:		
Amortizimin	1,093,423	593,319
Humbje nga këmbimet valutore	2,575,240	9,170,808
Shpenzime për interesa	(23,359,533)	(19,655,255)
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	(612,335,801)	(533,211,513)
Rritje/rënie në tepricën inventarit	(149,932,579)	(141,955,423)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	514,649,148	423,927,491
Parate e përfituara nga aktivitetet	17,315,824	6,741,223
Tatim mbi fitimin i paguar	(31,108,584)	(28,983,677)
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	(13,792,760)	(22,242,454)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara	0	(2,000,000)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(5,185,110)	(2,555,230)
Interesi i arkëtuar	23,359,533	19,655,255
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese	18,174,423	15,100,025
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	(1,893,025)	16,004,601
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare	(1,893,025)	16,004,601
Diferenca konvertimi MM te mbajtura ne monedhe te huaj	(2,575,240)	(9,170,808)
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	(86,602)	(308,635)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	11,281,590	11,590,225
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	11,194,988	11,281,590

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALEVE TE VETA
Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2012


	Kapitali aksionar që i përket aksionerëve të shoqërisë			Totali
	Kapitali aksionar	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitimi i Pashpërndare	
Pozicioni më 31 dhjetor 2010	2,000,000	-	66,343,049	68,343,049
Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit				
Totali i të ardhurave apo i shpenzimeve, qe nuk jane njohur në PASH				
Fitimi neto i vitit financiar			238,888,120	238,888,120
Dividendët e paguar				
Axhustim prej rivleresimit nga kontrollet tatimore				-
Transferim ne kapitalin Aksionar	66,948,051		66,948,051	-
Aksione të thesarit të riblera				
Pozicioni më 31 dhjetor 2011	68,948,051	-	238,283,118	307,231,169
Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit				
Totali i të ardhurave apo i shpenzimeve, qe nuk jane njohur në PASH				
Fitimi neto për periudhën kontabël			253,517,342	253,517,342
Dividendët e paguar				-
Aksione të thesarit të riblera				-
Transferim ne rezerva te tjera		238,283,118	238,283,118	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	68,948,051	238,283,118	253,517,342	560,748,511

Pasqyrat Financiare te shoqerise A&V-Gas sha per periudhen Janar – Dhjetor 2012 jane aprovuar nga drejtimi me date _____

Orledia Bare
Administratori



Fredi Gjergji
Ekonomisti



Shenimet shpejtqese jane pjese integrale e pasqyrave financiare

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Te dhena te pergjithshme mbi Shoqerine

Shoqeria "A&V - GAS" SHA eshte krijuar ne vitin 23 Tetor 2009. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj si dhe nga ligji nr. 7638 date 19 Nentor 1992 "Per shoqerite tregetare". Shoqeria A&V - Gas sha eshte nje shoqeri shqiptare me perfaqesues ligjor Znj. Orledia Bare. Ortaku i vetem i shoqerise eshte Z. Pirro Bare i cili zoteron 100 % te kuotave te kapitalit.

Selia e shoqerise eshte: 700 M ne veri te Hidrovorit, Porto-Romano, Durres. Ajo eshte regjistruar prane organeve tatimore te rrethit te Durres me NIPT K922235030.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte tregtimi me pakice dhe shumice si dhe shperndarja e naftes, benzines gazit dhe nenprodukteve dhe derivateve te tyre. Ndertimi dhe marrja me qera e fabrikave instalimeve dhe rafinerive per rafinimin, prodhimin, perpunimin, depozitimn e hidrokarbureve. Transporti kombetar dhe nderkombetar nepermjet agjensive detare e tokesore spedicionare etj.

2. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pregatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura date 15.06.2006.

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pregatitur mbi bazen e kostos historike, me perjashtim te rasteve qe percaktohet ndryshe ne se ka te tilla.

b. Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel

Rishikimi i vleresimit kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (cmuarja) eshte bere dhe ne cdo periudhe qe preket ne te ardhmen.

c. Monedha Funktionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e shoqerise. Informacioni financiar eshte paraqitur ne Leke.

d. Vleresimit te likujditeve

Gjendjet e likujditeve perfshijne gjendjen e parave ne arke dhe ne llogarite rrjedhese ne banke ne leke dhe ne monedha te huaja sipas ekstrakteve bankare.

e. Vleresimin e kerkesave per arketim

Kerkesat per arketim vleresohen me vleren nominale (te skontuara nese eshte materiale) minus humbjen nga zhvleresimi.

f. Vleresimin e detyrimve te pagueshme ndaj furnitoreve

Detyrimet ndaj furnitoreve jane te vleresuara mbi bazen e vleres se tyre nominale.

g. Huate

Huate e marra me interes regjistrohen fillimisht me vleren e drejte. Pas njohjes fillestare jane te vleresuara me koston e amortizuar. Interesat e perlllogaritur jane njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe detyrim ne llogarine e interesave te perlllogaritura.

h. Veprimet ne monedha te huaja

Transaksioneve ne monedhe te huaj regjistrohen ne kontabilitet me kursin e dates se kryerjes se transaksionit.

Shenime mbi Pasqyrat Financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2012

Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane perkthyer ne pasqyren e bilancit me kursin e kembimit te Bankes se Shqiperise me 31.12.2012. Diferencat nga kursi i kembimit te lindura nga perkthimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen duke perdorur kursine kembimit ne daten e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe paraqiten me vleren e drejte perkthehen me kursin e kembimit ne daten kur vlera e drejte eshte percaktuar.

Kursi i kembimit per dy monedhat e huaja kryesore me monedhen vendase sipas te Bankes se Shqiperise me 31.12.2012, ka qene respektivisht si me poshte:

	2012	2011
1 Euro	139.59	138.93
1 USD	105.85	107.54

i. Vleresimin e Gjendjeve te Inventarit.

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Ne rastin e prodhimit te produkteve ne kosto perfshifet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Koston e inventarit llogaritet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar

Gjendjet e Inventarit jane te vleresuara ne bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar kete vleresim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

j. Vleresimi Aktiveve Afatgjata Materiale

Aktivt Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten ne bilanc me vleren e tyre neto (kosto historike minus amortizimin e akumuluar). Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen ne kontabilitet me koston se marrjes ose te prodhimit te tyre.

Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle ate aktiv ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Kosto e prodhimit te tyre perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per te prodhuar ate aktiv ne vendin dhe kushtet ekzistuese ku permendim shpenzimet e materialeve te para, shpenzime paga dhe sigurime shoqerore, taksa dhe tarifa doganore, interesa kredie, shpenzime mirmbajtje zyre dhe makina, amortizimi i Aqt-ve qe jane perdorur dhe shpenzime te tjera te njohura administrative.

Normat e amortizimit te aplikuaru jane sipas kerkesave fiskale dhe nuk marrin ne konsiderate vleresimin e amortizimit sipas jetes se dobishme te aktivit.

Per llogaritjen e amortizimit jane aplikuar keto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz ne %		Metoda e llogaritjes
	2012	2011	
Toka	0	0	
Ndetime e instalime	5	5	
Makineri e Paisje	20	20	Mbi vleren e mbetur te AQT-ve
Mjete transporti	20	20	
Paisje zyre	20	20	
Paisje kompiuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

Llogaritja e amortizimit per AQT e hyra gjate vitit behet duke filluar nga data nje e muajit pasardhes.

k. Provizionet

Nje provizion krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

l. Te Ardhurat

Te ardhurat regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe lidhjes qe ato kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pamvaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes. Te ardhurat nga interesat regjistrohen ne momentin e maturimit te tyre.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve te veta.

m. Tatimi mbi fitimin

Tatimi aktual mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per tatimin mbi te Ardhurat ne Republiken e Shqiperise" duke perfshire gjithë detyrimet per tatimin mbi fitimin te pagueshme per vitin ushtrimor. Tatimet aktuale jane tatime per tu paguar qe rezultojne nga te ardhurat e tatueshme, duke perdorur shkallen tatimore qe eshte ne fuqi ne daten e bilancit, dhe çdo rregullim ne tatimet per tu paguar qe rrjedh nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore per tatimin mbi fitimin per vitin ushtrimor eshte 10%.

n. Organizimi i Kontabilitetit

Shoqeria ka ngritur zyren e finances dhe kontabiliteti mbahet nga nje financier. Aktiviteti i shoqerise eshte i perqendruar ne Durres, ku shoqeria ka marre me qera dy depozitat e gazit dhe disa zyra administrative. Shoqeria ka organizuar dhe mban edhe kontabilitetin analitik ne funksion te nevojave te kontrollit dhe analizave te brendshme.

3. Likuiditete dhe Vlera te tjera Arke.

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Deposita ne banke e llogari te tjera	10,774	8,482
Vlera ne Arke	421	2,800
Totali	11,195	11,282

4. Kliente per shitje e sherbime

Shuma ne bilanc paraqet kerkesat per arketim ndaj klienteve te shoqerise per shitje gazi si me poshte:

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Kliente per fatuara te leshuara	726,161	449,390
Totali	726,161	449,390

5. Llogari kerkesa te tjera te arketueshme

Nje analize e ketyre kerkesave jepet ne tabelen e meposhtme:

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Detyrim Tvsh-je ne Dogane	3,769	0
TVSh e Zbritshme	38,861	4,761
Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve	968,758	671,064
Debitore dhe kreditore te tjere	2,201	2,200
Totali	1,013,589	678,025

Shuma prej **38,861 mije** leke eshte gjendja e Tvsh-s kreditore qe kompania jone ka si parapagim i tvsh-se ne dogane gjate çdoganimit te gazit. Gjithashtu shoqeria ka dhene e ka marre fonde monetare ndaj ortakut. Nuk ka llogaritje interesash per keto fonde dhe kthimi apo arketimi i tyre do te behet bazuar ne gjendjen financiare te paleve te perfshira.

6. Inventari

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Mallra	347,019	197,087
Totali	347,019	197,087

Shoqeria ka kryer inventarizimin e gjendjeve te inventarit ne fund te vitit, rezultatet e te cilit perputhen me vleren e stokut te pasqyruar ne bilanc qe perbehet vetem nga gaz i lengshem.

Ne mbyllje te vitit ushtrimor jane kryer llogaritje te sakta per pasqyrimin ne rezultatin e ushtrimit te efekteve te ndryshimit te gjendjeve te inventarit. Kontabilizimi i veprimeve me stokun kryhet konform normave kontabel.

7. Aksione ne shoqerite e kontrolluara

Kjo llogari tregon shumen prej 2,000 mije leke si kapital fillestar qe shoqeria ka investuar ne nje shoqeri tjeter ku ajo eshte 100 % aksionere.

8. AAM-Toka, ndertesa, makineri e pajisje, aktive te tjera afatgjata

Levizjet e Aktiveve e Afatgjata Materiale (AAM) gjate vitit ushtrimor jane pasqyruar ne tabelen e meposhtme:

Pershkrimi			Toka	Makineri Pajisje	Automjetet	Te tjera	Ne proces	TOTAL
Bilanci i Celjes	01.01.2012	AQT Vlera Bruto	0	0	2,484,000	1,136,000	0	3,620,000
Bilanci i Celjes	01.01.2012	Amortiz Akumul	0	0	(414,000)	(374,545)	0	(788,545)
Bilanci i Celjes	01.01.2012	Provizione						0
Bilanci i Celjes	01.01.2012	VLERA NETO	0	0	2,070,000	761,455	0	2,831,455
Hyrjet	2012	Vlera Bruto	0	0	4,856,950	328,160	0	5,185,110
Daljet	2012	Vlera Bruto	0	0	0	0	0	0
Riklasifikim i Aktiveve				0	0	0	0	0
Amortizimi i Vitit Ushtrimor					(899,695)	(193,728)	0	(1,093,423)
Provizionet								0
Rimarje e Amortizimit								0
Rimarje e Provizioneve								0
Riklasifikim i Amortizimeve								0
		AQT Vlera						
Bilanci i Mbylljes 31.12.2012		Bruto	0	0	7,340,950	1,464,160	0	8,805,110
Bilanci i Mbylljes	31.12.2012	Amortiz Akumul	0	0	(1,313,695)	(568,273)	0	(1,881,968)
Bilanci i Mbylljes	31.12.2012	Provizione	0	0	0	0	0	0
Bilanci i Celjes	01.01.2013	VLERA NETO	0	0	6,027,255	895,887	0	6,923,142

Shoqeria ka respektuar rregullat dhe normat tatimore ne llogaritjen e amortizimit te AQT-ve.

9. Huate dhe obligacionet afatshkurtra

Kjo llogari paraqet detyrimin e dy overdrafteve marre nga shoqeria jone per mjete qarkulluese sipas tabelës se meposhtme:

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Hua afatshkurtra (overdraft)	268,609	264,921
Totali	268,609	264,921

10. Te pagueshme ndaj furnitoreve

Kjo llogari paraqet detyrimin ndaj furnitoreve per furnizime me mallra dhe sherbime sipas tabelës : Shoqeria ka mbajtur ne kontabilitet kartela analitike per çdo furnitor.

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Furnitore per fatura te pranuar	1,106,270	584,459
Totali	1,106,270	584,459

11. Detyrime tatimore

Kjo llogari paraqitet detyrimet per tu paguar per sigurime shoqerore e shendetesore, tatim mbi te ardhurat nga pagat, tatim fitimi si dhe tvsh per tu paguar ne dogane e detajuar sipas tabelës se meposhtme:

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Tatim Fitimi	11,864	20,962
Sigurimet Shoqerore	127	108
Tatim mbi te Ardhurat Personale te Punonjesve	42	37
Det.per takse Dog-Tvsh ne dogane		7,891
Totali	12,033	28,998

Te gjitha detyrimet tatimore jane shlyer ne Janar te viti 2013.

12. Parapagimet e arketueshme

Ne kete llogari paraqiten parapagimet e klienteve me 31 dhjetor 2012 per blerjen e gazit ne shumen **6,115 mije leke**.

13. Huamarrje afatgjata

Ne kete llogari kemi vleren prej **92,337 mije leke** per nje kredi afatmesme marre gjate vitit 2010

14. Huamarrje te tjera afatgjata

Kjo llogari per vitin 2012 paraqitet ne vleren **60,775 mije leke**. Keto jane fonde pa interes qe shoqeria u detyrohet shoqerive te tjera ne pronesi te ortakut, te cilat mbahen analitikisht.

15. Kapitali

Llogaria e kapitalit per vitin 2012 paraqitet e detajuar ne dy tabelat si me poshte:

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Kapitali aksionar	68,948	68,948
Rezerva te Tjera	238,283	
Fitim I pashperndare	0	(605)
Fitim (Humbje) viti 2012	253,517	238,888
Totali	560,748	307,231

16. Te Ardhurat

Shifrat vjetore e afarizmit per vitin 2012 paraqitet si me poshte:

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Nga shitja e materialeve/ mallrave LPG	5,820,456	5,330,834
Totali	5,820,456	5,330,834

17. Mallra, lendet e para dhe sherbimet

Llogaria shpenzime mallra (GAZ) me 31 Dhjetor 2012 paraqitet si me poshte :

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Mallra	5,306,925	4,859,550
Totali	5,306,925	4,859,550

18. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Struktura e shpenzimeve operative te kryera per vitin 2012 paraqitet si me poshte:

Pershkrimi	2012	2011
	ALL '000	ALL '000
Shpenzime qira	161,708	150,966
Shpenzime te tjera	25,863	17,712
Shpenzime telefonie	1,873	2,560
Shpenzime perfaqesimi	37	199
Shpenzime transferim, udhetim dhe dieta	2,766	326
Publicitet & reklama	23	84
Gjoha dhe demshperblime	26,459	21,965
Sherbime bankare	6,984	6,962
Totali	225,713	200,774

"A&V - Gas" Sha Durres

Shenime mbi Pasqyrat Financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2012

19. Shpenzime personeli

Struktura shpenzime personeli per vitin 2012 paraqitet si me poshte:

Pershkrimi	2012 ALL '000	2011 ALL '000
Shpenzime pagash	5,403	4,704
Sigurime shoqerore e shendetesore	832	707
Totali	6,235	5,411

20. Shpenzime amortizimi

Amortizimi i llogaritur per AQT per vitin 2012 eshte **1,093** mije leke.

21. Te ardhura dhe shpenzime financiare

Struktura te ardhura dhe shpenzime financiare ne date 31 Dhjetor 2012 paraqitet si me poshte :

Pershkrimi	2012 ALL '000	2011 ALL '000
Te Ardhura Financiare		
Interesa Pozitive	2	23
Diferenca Pozitive Kembimi	15,583	38,520
Shenzime Financiare		
Interesa te llogaritura	(23,362)	(19,678)
Diferenca negative kembimi	(13,007)	(29,349)
	(20,784)	(10,484)

22. Shpenzimet e tatim mbi fitimin

Shoqeria A&V Gas sha ka rezultuar me fitim kontabel dhe tatimor. Ne percaktimin e rezultatit tatimor shoqeria nuk ka konstatuar per efekte fiskale shpenzime te panjohura. Po ofrojme me poshte nje pasqyre te detajuar:

Pershkrimi	2012 ALL '000	2011 ALL '000
Rezultati Kontabel	284,626	267,872
Gjoba, penalitete e demshperblime	26,459	21,965
Rezultati Tatimor	311,085	289,837
Tatimi mbi Fitimin	31,109	28,984

23. Transaksionet me palet e lidhura

Pale te lidhura konsiderohen si te tilla ne rast se njera pale e kamundesine te kontrolloje palen tjetere ose te ushtroje nje influence te ndjeshme mbi kete pale, ne marrjen e vendimeve financiare dhe te shfrytezimit. Transaksionet me palet e lidhura te shoqerise detajohen si me poshte:

Pershkrimi	2012 ALL'000
Totali i shitjeve me palet e lidhura	395,615
Totali i blerjeve me palet e lidhura	254,323

"A&V - Gas" Sha Durres

Shenime mbi Pasqyrat Financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2012

Gjendja ne 31.12.2012 me palet e lidhura detajohet si meposhte:

Pershkrimi	2012 ALL'000
Total Debitime	1,796,008
Total Kreditime	999,307
Teprica Debitore me 31.12.2012	796,701

Perfitimet e administratorës se Shoqërise Zj. Orleida Bare per periudhen Janar – Dhjetor 2012. Paraqiten ne vleren 1,500 mije leke.